AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë 08/05/2023

Nr. K1/I 89- 8 Prot.

Nr.dok. 202201309/8

Lënda: *Rekomandohet trajtimi i kërkësës/ankesës së qytetarit në lidhje me dëmet e shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019 në banesën e tij dhe mundësisë për të përfituar në një nga programet e strehimit të Bashkisë Kurbin.*

BASHKISË KURBIN

I nderuar Z. Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike[1], nisur nga kronika e transmetuar në median "TV Lezha", në datën 03.09.2022, ***"Nuk merr zgjidhje nga autoritetet, P. P. u drejtohet mediave"***[2], ka filluar ndjekjen e kësaj çështjeje.

Pas regjistrimit të rastit dhe marrjen e çështjes për shqyrtim, Avokati i Popullit në respektim të detyrimeve ligjore që rrjedhin në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit, për garantimin e të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve, që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ky rast plotëson të gjitha kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për tu konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ka çelur hetimin administrativ dhe me shkresën e tij "Kërkesë për shpjegime"[3] i është drejtuar institucionit Tuaj, duke kërkuar shpjegime për rastin e publikuar në media, duke ju vënë në dispozicion të gjithë informacionin lidhur me pretendimet e qytetarit në ankesën publike sa më poshtë:

Pashk Pepa, banues në qytetin e Laçit, ka kërkuar ndihmë nga shteti për problematikën e krijuar nga tërmeti në 26 nëntor 2019, në lidhje dëmtimet në banesën e tij. Në kronikë ai shprehet se banesa e tij, e ndodhur në një pallat pesë katësh, në Laç, është dëmtuar nga tërmeti dhe është vlerësuar nga ekpertët në nivelin e demtimit DS3 ***(e pabanueshme).*** *Qytetari ankohet sepse ndonësë ka jetuar me qera ai nuk ka më mundësi ekonomike për ta përballuar atë dhe është*

[1] Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar me nismën e tij, ndjekjen e kësaj çështjeje.

[2] https://www.youtube.com/watch?v=gFRVAI3Ru5A

[3] Shkresa nr. K1/I98-2 Prot, datë 01.12.2022 "Kërkesë për shpjegime".

detyruar të rikthehet në banesën e dëmtuar. Nuk ka përfituar bonus qeraje ndonësë banorët e tjerë të pallatit, disa prej të cilëve banojnë dhe jashtë shtetit, kanë përfituar bonuset dhe për më tepër kanë lëshuar dhe shtëpitë me qera.

Ai ankohet se nuk dëgjohet nga autoritetet përgjegjëse ndonëse është përpjekur të sqarojë situatën ku ai ndodhet.

Z. P. P. banesën tashmë të dëmtuar nga tërmeti, e ka përfituar nga kontributi vullnetar nga ndërrmarja Parku i Mallrave, Laç, që në vitin 1993, por nuk e ka në pronësi. Ai disponon të gjithë dokumentacionin ku cilësohet dhe familja e tij si e pastrehë (VKB i vitit 2002). Në kronikë cilësohet fakti që burimet pranë Bashkisë Laç janë shprehur se ndërhyrja për rregullimin e pallatit pesëkatesh do bëhet e plotë për të gjithë ndërtesën, por pas përfundimit të rrjetit të kanalizimeve të ujësjellësit të ri.

Ndërkohë familja e z. P.P. vazhdon të banojë në një ndërtesë të pabanueshme (dëmtuar nga tërmeti në nivelin DS3) për shkak të pamundësisë ekonomike për të përballuar vetë qeranë.

Sa më sipër qytetari bën apel publik për zgjidhjen e problematikës së tij për strehimin duke kërkuar mbështetje nga Bashkia Kurbin.

Më tej në mungesë të përgjigjes nga institucioni Juaj, institucioni i Avokatit të Popullit Ju është drejtuar me dy kërkesa të përsëritura për informacion[4] me qëllim zgjidhjen e problematikës së ngritur në media, por përsëri nuk ka patur asnjë përgjigje, informacion apo shpjegime rreth shkaqeve të cilat justifikojnë qëndrimin e Bashkisë Kurbin në raport me qytetarin, në kundërshtim me:

- pikën 4, të nenit 63, të *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*, ku parashikohet në mënyrë eksplicite se: "Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij";

- nenin 19/b të *Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit",* që parashikon se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin", si edhe paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.";

Sa më sipër vlerësojmë se:

Qëndrimi i punonjësve të Bashkisë Kurbin, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efiçencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të *Ligjit Nr.44/2015*, *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",* të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 1 të këtij Kodi.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se punonjësit e Bashkisë Kurbin nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor në marrëdhënien me institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë për institucionin e Avokatit të Pupullit, në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efiçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm.

Parë në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit gjithashtu vlerëson se është e nevojshme marrja e masave për një vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni i Bashkisë Kurbin,

[4] Shkresa nr. K1/I98-5 Prot, datë 20.12.2022 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime"dhe shkresa nr. K1/I98-6 Prot, datë 15.02.2023 "Kërkësë e përsëritur për shpjegime".

çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe shkëmbim të plotë dhe shterues të informacioneve të nevojshme bazuar në përcaktimet ligjore, për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.

Për sa më lart, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se: *"Avokati i Populllit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozoje masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike",* dhe nenet 21, 22 e 22/1 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Populllit",* të ndryshuar,

R E K O M A N D O J M Ë

- *Marrjen e masave nga Bashkia Kurbin për trajtimin e kërkësës/ankesës së qytetarit lidhur me dëmet e shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019 në banesën e tij dhe mundësive të përfshirjes së familjes P. në një nga programet e strehimit social, bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", si dhe akteve nënligjore përkatëse.*
- *Koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe marrjen e masave për një vlerësim serioz të mënyrës se si duhet të trajtohen nga institucioni juaj çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe një shkëmbim të drejtë e shterues të informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.*
- *Marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit/ve të Bashkisë Kurbin që nuk ka/kanë përmbushur dhe nuk përmbush/përmbushin detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Populllitm apo me subjektin ankues.*

Në përputhje me nenin 22 të *Ligjit "Për Avokatin e Populllit"*, ku thuhet shprehimisht se: **"*Organet të cilave Avokati i Populllit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*",**

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

Me urdhër dhe porosi

KOMISIONERI

AHMET PRENÇI
DV